



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 138 / Prot
1

Tiranë, më 11 / 04 / 2025

VENDIM

Nr. 2, datë 09/04/2025

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT DHE NËNKRYETARIT
TË BORDIT

Në mbështetje të nenit 10 pika 1 i Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 "*Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri*" i ndryshuar, dhe Kreut I "*Akti Administrativ*" i "*Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë*", në përfundim të mbledhjes Bordi,

VENDOSI

1. Zgjedhjen e Z.Mentor Beqa si Kryetar i Bordit.
2. Zgjedhjen e Znj.Laureta Roshi si Nënkyetare e Bordit.

Anëtarët e Bordit:

Mentor Beqa

Simon Mirakaj

Vasil Tole

Etleva Smaci

Loreta Roshi

Alma Mirakaj

Niuton Mulleti

Konc:F.Loshe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 138 prot

Tiranë më 09/04 / 2025

PROCESVERBAL
MBLEDHJE BORDI

(Datë, 09/04/2025)

Të pranishëm nga Bordi: Të pranishëm nga Bordi: Vasil Tole, Mentor Beqa, Alma Mirakaj, Etleva Smaçi, Simon Mirakaj, Niuton Mulleti, Laureta Roshi.

Të gjithë anëtarët e Bordit zgjedhin z. Vasil Tole për të bërë hapjen e mbledhjes.

V.Tole: Përshëndetje të gjithëve! Së pari, ju uroj shumë suksese në këtë detyrë të nderuar, e cila fokusohet në një mision me rëndësi të veçantë: studimin dhe dokumentimin e periudhës së diktaturës komuniste. Një falënderim i veçantë shkon për anëtarët e Bordit të mëparshëm, për frymën bashkëpunuese, pjesëmarrjen aktive në mbledhje dhe kontributin e tyre gjatë mandatit të kaluar. Në këtë mbledhje konstituive të Bordit, i japim jetë mandateve tona të reja. Sipas nenit 10 të Ligjit 10242 për krijimin e ISKK, jemi mbledhur të zgjedhim Kryetarin dhe Nënkryetarin e Bordit, përmes votimit. Propozoj që të vijojmë me një prezantim të shkurtër nga secili anëtar, pas së cilës do të fillojmë me propozimet.

S.Mirakaj: Unë quhem Simon Mirakaj dhe kam qenë pjesë e administratës shtetërore që prej vitit 1993. Për një periudhë prej 12 vitesh kam ushtruar detyrën si Drejtor i Institutit të Integritetit të Ish-të Përndjekurve Politikë. Gjithashtu, kam dhënë kontributin tim për 6 vite si anëtar i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (1944–1991), një angazhim të cilin vazhdoj ta mbaj edhe sot. Gjatë gjithë kësaj periudhe, kam qenë i përkushtuar në përpjekjet për të dokumentuar, analizuar dhe përçarur të vërtetën historike në lidhje me periudhën e regjimit komunist dhe pasojat e tij në shoqërinë shqiptare.

L.Roshi: Unë jam Laureta Roshi, dhe vij nga fusha e medias. Gjatë karrierës sime, kam qenë e përkushtuar ndaj temave që prekin dinjitetin dhe të drejtat e publikut, jo vetëm përmes medias, por edhe përmes studimeve të mia në fushën e psikoterapisë. Besoj fort në fuqinë e medias si një mjet jo vetëm informues, por edhe ndërgjegjëses dhe mbrojtës i dinjitetit njerëzor.

E.Smaci: Jam Etleva Smaci, me një formim akademik dhe eksperiencë të gjatë në këte fushë. Vija nga Konferenca e Rektorëve, me fokus kryesor studimin e periudhës 1945–1960. Deri më sot, kam dhënë kontributin tim në 2 konferenca të ndryshme, të gjitha të përqendruara në analizën dhe trajtimin e kësaj shtrese shoqërore. Synimi përfundimtar është kontributi drejt arritjes së një ndjese morale ndaj kësaj periudhe dhe individëve të prekur prej saj.

A.Mirakaj: Unë jam Alma Mirakaj dhe vij nga Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë. Gjatë karrierës sime, kam punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ku në vitin 2014 u largova nga puna për arsye politike. Kam dhënë kontribut prej disa vitesh si autore dhe përkthyes, ndërsa në kuadër të punës sime pranë ISKK-së, kam botuar dy memuarë të cilët trajtojnë temat e persekutimit, rezistencës dhe kujtesës historike.

M.Beqa: Unë jam Mentor Beqa, aktualisht pedagog i Shkencave Politike pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Prej disa vitesh kam dhënë kontributin tim në media, në administratën publike dhe në jetën akademike. Ndihej shumë i nderuar për zgjedhjen si anëtar i Bordit të ISKK, një detyrim moral dhe personal ndaj historisë së familjes sime, pasi babai im ka qenë i internuar në Kampin e Tepelenës që në moshën 7-vjeçare. Nëpërmjet këtij angazhimi, synoj të jap kontributin tim për ruajtjen e kujtesës historike dhe respektimin e së vërtetës.

N.Mulleti: Unë jam Niuton Mulleti dhe aktualisht ushtroj detyrën si pedagog në Universitetin Epoka, në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë. Që nga viti 2008, jam angazhuar në fushën akademike, duke mbajtur disa pozicione drejtuese të nivelit të mesëm. Njëkohësisht, që nga muaji tetor 2023, ushtroj detyrën e Zëvendësrektorit për çështje akademike në të njëjtin universitet. Jam propozuar nga Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë dhe jam i nderuar në zgjedhjen si anëtar i Bordit të ISKK, si një aktor kyç në fushën e drejtësisë tranzitore, ku kam qenë i përqendruar në mënyrë të veçantë. Kontributi im ka qenë i vazhdueshëm në këtë fushë përmes kërkimeve, angazhimit akademik dhe bashkëpunimeve me partneritetet e huaja.

V.Tole: Unë jam Vasil Tole, aktualisht në mandatin tim të dytë si anëtar i Bordit të ISKK. Vija nga bota akademike, me një karrierë të konsoliduar në Akademinë e Shkencave dhe aktualisht në Universitetin e Arteve të Tiranës, ku ushtroj edhe funksione administrative. Angazhimi im në ISKK lidhet ngushtë me përkushtimin tim ndaj kujtesës historike veçanërisht në lidhje me periudhën e regjimit komunist dhe pasojat e tij në shoqërinë shqiptare. Tani që u prezantuam, propozoj të kalojmë te diskutimi i propozimeve për Kryetar dhe Nenkryetar.

S.Mirakaj: Unë propozoj Niuton Mulletin si Kryetar Bordi.

N.Mulleti: Ju falenderoj për propozimin. Megjithatë, për shkak të angazhimeve të shumta që kam aktualisht, mendoj se nuk do të mund t'i përkushtohem plotësisht kësaj detyre. Për këtë arsye, sugjeroj që Kryetari i Bordit të jetë një person që mund të angazhohet me kohë të plotë dhe përkushtim maksimal. Në këtë kontekst, propozoj z. Mentor si Kryetar, duke u mbështetur në punën e tij të deritanishme dhe përvojën e tij jetësore.

M.Beqa: Faleminderit për propozimin. Duke vlerësuar përvojën e deritanishme dhe maturinë që e karakterizon, propozoj znj. Laureta për pozicionin e Nënkyetares së Bordit.

L.Roshi: Faleminderit për propozimin dhe jam dakort.

V. Tole: Atëherë nëse jeni dakort bëjmë një votim të hapur duke qënë se nuk kemi kandidatura alternative.

Jeni dakort për zgjedhjen e Z. Mentor Beqa si kryetar të Bordit të ISKK?

- **7 anëtarët e Bordit votuan pro zgjedhjes së Z. Mentor Beqa**

Jeni dakort për zgjedhjen e Znj. Laureta Roshi si Nënkyetare e Bordit të ISKK?

- **7 anëtarët e Bordit votuan pro zgjedhjes së Znj. Laureta Roshi si nënkyetare të Bordit të ISKK.**

M.Beqa: Ju falënderoj të gjithëve dhe uroj që të kemi një bashkëpunim sa më harmonik në vijim. Sfida më e madhe që kemi përpara është rikthimi në zyrat e mëparshme të Institutit, të cilat mbartin një rëndësi të veçantë simbolike dhe funksionale. Do të doja që në vijim të dëgjonim edhe mendimet tuaja mbi mënyrat konkrete se si mund të procedojmë, me synimin që kjo hapësirë të funksionojë si një zonë memoriale e ISKK. Zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv dhe finalizimi i Raportit Vjetor përbëjnë gjithashtu sfida të rëndësishme që na presin në vazhdim.

L.Roshi: I bashkohem plotësisht nismës për të lobuar për rikthimin e zyrës së mëparshme të ISKK. Kjo hapësirë ka pasur një rëndësi të veçantë simbolike dhe funksionale, si një pikë referimi për qytetarët dhe studiuesit. Ajo ofronte më shumë akses dhe dukshmëri, veçanërisht për studentët dhe të rinjtë e interesuar në temën e kujtesës historike. Rikthimi aty do të forconte praninë publike dhe rolin institucional të ISKK.

V.Tole: Mentor, unë mendoj se së pari duhet të rishikojmë planin vjetor të punës, në mënyrë që ta analizojmë me një sy të ri dhe të bëjmë përmirësimet e nevojshme. Gjithashtu, e shoh të arsyeshme që të mblidhemi sërish për të diskutuar dhe përcaktuar kriteret për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv, pasi mandati i tij ka përfunduar dhe është e rëndësishme që ky proces të mos zvarritet. Për sa i përket çështjes së godinës, jam plotësisht dakord që ne si Bord duhet të ndërmarrim hapat e nevojshëm sa më parë, duke pasur parasysh natyrën emergjente të kësaj situate.

E.Smaci: Për çështjen e godinës, është e nevojshme të kemi një pasqyrë më të plotë mbi situatën. Kërkohej të vihet në dispozicion një raport përmbljedhës që të përfshijë:

1. Dokumentacionin përkatës që lidhet me godinën;
2. Hapat që janë ndërmarrë deri tani, që nga momenti i dorëzimit të zyrave për punime;
3. Përpjekjet institucionale të bëra në këtë drejtim;
4. Dhe, shumë e rëndësishme, statusi aktual i pronësisë së godinës.

Ky informacion do të na ndihmojë të kemi një panoramë të qartë për të ndjekur më tej hapat e nevojshëm.

M.Beqa: Sa i përket çështjes së zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv, ju lutem të na vini në dispozicion një raport mbi statusin juridik të këtij pozicioni: kur ka përfunduar mandati, dhe nëse ky pozicion ndikohet nga pezullimet e rekrutimeve gjatë periudhës zgjedhore. Ndërkohë, për çështjen e godinës, do të ishte e udhës të kishim një raport përmbledhës që nga momenti i dorëzimit të zyrave për punime, përpjekjet e ndërmarra deri tani dhe statusin aktual të kësaj godine. Ky raport të jetë i disponueshëm brenda javës së ardhshme.

Me miratimin tuaj, propozoj të dërgojmë një shkresë zyrtare në emër të Bordit drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Kulturës dhe Delegacionit të Bashkimit European, lidhur me këtë çështje.

- 7 anëtarët e Bordit janë dakort për nisjen e shkresës.

Mentor Beqa.....

Simon Mirakaj.....

Vasil Tole.....

Etleva Smaci.....

Loreta Roshi.....

Alma Mirakaj.....

Niuton Mulleti.....

Perpiloti: Franceska Loshe